

Provim me shkrim
SHQIP

Mbiemri

Emri

Pikët e arritura:

Detyra 1: ____/20

Detyra 2: ____/10

Detyra 3: ____/10

Detyra 4: ____/20

Detyra 5: ____/12

Detyra 6: ____/8

Gjithsej: _____/80^[L]_[SEP]

Hyrja në provim me gojë lejohet mbi 48 pikë (= 60 %)

Detyrë 1

Lexoni me kujdes përshkrimin e situatës dhe kërkesën e detyrës 1. Koha në dispozicion 2 minuta.

Situata:

Ju do të dëgjoni intervistën e parë nga emisioni Target i Radio Tiranës. Në këto intervistë do të diskutohet me studiues të shqipes mbi sfidat e rreziqet me të cilat përballet sot gjuha shqipe.

Kërkesa e detyrës:

Përfytyroni një situatë si më poshtë:

Në studiot e RTSH-së transmetohet një program direkt me temë gjuhën shqipe dhe sfidat e pengesat që ajo has. I ftuar në studio është akademiku Valter Memisha, i cili do t'i përgjigjet pyetjeve të dëgjuesve dhe dëgjueseve.¹ Një dëgjuese ka këtë pyetje:

I nderuar z. Valter Memisha,

A mund të shpjegoni shkurt se cilat janë sfidat e pengesat me të cilat përballet përdorimi i gjuhës shqipe sot?

Ju falenderoj,

Albana nga Shkodra

Në bazë të informacioneve nga intervista që do të dëgjoni, përgjigjuni me shkrim kësaj pyetjeje

Hapi 1:

Ju do të dëgjoni dy herë opinionin e akademikut Valter Memisha mbi temën në fjalë. Mbani shënime mbi informacionet që ju duken të rëndësishme e ju ndihmojnë të shkruani përgjigjen.

(von 2'27 bis 9')

¹ https://www.youtube.com/watch?v=H_9_OWxN9SI

Hapi 2:

Përpiloni tani përgjigjen. Koha në dispozicion është 15 minuta.

Lutja e Albanës nga Shkodra:

I nderuar Prof. Valter Memisha!

A mund të shpjegoni shkurt se cilat janë sfidat e pengesat me të cilat perballet gjuha shqipe sot?

Ju falenderoj!

Albana nga Shkodra

Përgjigjja e z. Memisha:

E nderuar Albana,

Detyrë 2

Lexoni me kujdes kërkesën e detyrës 2. Koha në dispozicion 1 Minutë.

Situata/ Kërkesa e detyrës:

Do të dëgjoni në vijim një pjesë nga biseda me Pedagogen e Gjuhësise, Aljula Jubani. Këtë pjesë do ta dëgjoni 10 herë.

Mbani shënim fjalë për fjalë çfarë keni dëgjuar, fjalët duhet të jenë të rradhitura si në tekstin e dëgjuar, në mënyrë që në fund të riprodhoni thënien e z. Jubani fjalë për fjalë. Fillimi dhe fundit i pjesës janë të dhëna.

(ab 11'47" bis 12'20")

Ne fillim të viteve 80 gjuha shqipe u hoq nga kurrikula e shkollave të mesme me argumentin se gjuha mesohet nepermjet letersise. Gjuha mesohet nepermjet letersise artistike dhe gjuha mesohet nepermjet cdo forme të shkruar por mesimi i sistemit gjuhesor, perfitimi i kompetencave gjuhesore, krijimi i nje ndergjegje te mire gjuhesore, ka nevojë për një program të specializuar.

Detyrë 3

Lexoni kërkesën e detyrës 3. Koha në dispozicion 2 minuta.

Kërkesa:

Do të dëgjoni intervistën e dytë nga emisioni Target, ku pedagogja Aljula Jubani shprehet mbi arësyet e nivelit të ulët në përdorimin e shqipes dhe parandalimin e tyre.

Lexoni thëniet më poshtë të grupuara në A, B, dhe C. Nga këto vetëm njëra është e saktë (A ose B ose C). Shënoni thënien e saktë duke vendosur një x në kutinë boshe. Intervistën do ta dëgjoni dy herë.

(9' bis 14' 34")

1. Futja e gjuhës shqipe në Universitete

A është e lidhur ngushtë me një iniciativë të nisur së pari nga mediat e komunikimit publik.

B shihet si domosdoshmëri për të luftuar nivelin e ulët të gjuhës tek të rinjtë.

C është një ide, që sapo ka lindur e diskutohet në shumë artikuj nga gazetarë e gjuhëtarë.

2. Lënda e kulturës gjuhësore

A është që prej 8 vitesh lëndë e detyrueshme në kurrikulat e fakulteteve të Universitetit të Tiranës.

B ka si qëllim të pajisë studentet e studentët me kompetencat e duhura gjuhësore.

C synon formimin gjuhësor dhe kulturor të studenteve dhe studentëve.

3. Në planet mësimore të shkollave të mesme

A është përfshirë që prej një viti lënda e gjuhës shqipe me qëllim rritjen e kompetencave dhe ndërgjegjes gjuhësore të nxënësve dhe nxënësve.

B ka munguar që nga vitet 80-të një program i specializuar për mësimin e gramatikës dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

C është planifikuar dhe ofrohet gjuha shqipe vetëm për maturantët.

4. Rritja e kompetencës gjuhësore në Universitet

A është e nevojshme sidomos për përkthimin në shqip të terminologjisë së fushave të ndryshme.

B është baza për përgatitjen akademike të specialisteve të së ardhmes.

C është e lidhur me mësimin e përvetësimin e gramatikes dhe morfologjisë së shqipes.

5. Së fundmi pedagogja Jubani thekson

A se rritja e ndërgjegjesimit gjuhësor duhet të fokusohet edhe në Universitetet jashtë vendit.

B se një kompetencë e lartë në gjuhën shqipe do të thotë një kompetencë e lartë dhe në gjuhët e huaja.

C se lënda e gjuhës shqipe në Universitet ndryshon nga dega në degë.

Lexoni me kujdes kërkesën e detyrës 4.

Kërkesë: Plotësoni në tekstin e mëposhtëm vendet bosh (numrat 1-5) me paragrafet A-G, në mënyrë që të krijohet një tekst i saktë nga përmbajtja dhe ana gjuhësore.

Vendosni në tabelë secilin paragraf poshtë numrit përkatës. Dy nga 7 paragrafët (A-G) nuk janë pjesë e tekstit origjinal.

	Numri 1	Numri 2	Numri 3	Numri 4	Numri 5
Paragrafi	G	B	C	E	D

Shkencëtarët kanë studiuar prej vitesh si ndikojnë vrimat e zeza tek hapësira rrotull tyre. Forca e tyre e rëndesës tjetëron kohën e hapësirën në një mënyrë që tani vërtetohet, ashtu siç e kishte parashikuar Albert Ajnshtajni. Por vrimat e zeza kanë qenë të padukshme për shkencëtarët, një fakt që tani është kapërcyer nga shkenca:

G Shkencëtarët kanë shpenzuar 10 vjet për të lidhur tetë teleskopë të ndryshëm në mbarë botën në një projekt mjaft të vështirë.

Dy vjet më parë, duke përdorur orë atomike tepër të sakta, secili nga teleskopët u kthye drejt galaktikës M-87 që ndodhet 55 milionë vite drite larg.

Pas analizimit të një morie të dhënash dhe pas verifikimit të rezultateve, shkencëtarët e projektit “Event Horizon Telescope” nxorën fotografinë e parë të një vrime të zezë:

B “Në prill 2017 të gjitha panelet e teleskopëve u kthyen në drejtim të galaktikës që ndodhet 55 milionë vjet dritë larg. Galaktika M-87 përmban një vrimë gjigande të zezë dhe jemi shumë të gëzuar që sot ju njoftojmë se kemi parë atë që mendohej se ishte e pamundur të shihej. Kemi parë dhe fotografuar një vrimë të zezë. Ja ku e kemi,” tha Sheperd Doeleman, një ndër shkencëtarët e përfshirë në projekt.

Në pamje nuk është shumë impresionuese: një formë sferike ngjyrë të verdhë në portokalli që pluskon në hapësirë.

C Por shkencëtarët gjithmonë e kanë imagjinuar të tillë formën e vrimës së zezë. Në qendër është zona e errësirës së plotë ku forca e rëndesës është aq e fortë saqë nuk lejon reflektimin e dritës. Rrotull saj ka një shtresë gazi dhe pluhuri në temperaturë tepër të lartë prej miliarda gradë celcius, që lëviz thujse me shpejtësinë e dritës.

“Mendohet se vrimat e zeza krijohen në fund të jetës së yjeve, kur ylli shpërbëhet brenda vetes dhe krijon një objekt me dendësi të lartë. Në rastin e galaktikës sonë, e dimë se ajo përmban një vrimë të zezë masive në qendër të saj. Është thujse aq e madhe sa orbita e Merkurit, me masë disa miliona herë më të madhe se ajo e Diellit tonë.

E Tani mendojmë se këto vrima të zeza masive gjenden në zemër të çdo galaktike,” thotë drejtori i Muzeut të Shkencës, Roger Highfield.

Vrimat e zeza janë tepër të fuqishme. Shtullungat e gazit përhapen në distanca prej miliona vjet drite nga qendra e vrimës së zezë. Forca e rëndesës është aq e fuqishme saqë tjetërson dritën që çlirojnë edhe diej masivë që ndodhen pranë tyre.

D Shkencëtarët thonë se fotografia shërben si udhërrëfyese për studime të tjera më të suksesshme:

“Kjo fotografi shërben si hallka që lidh vrimat e zeza masive me forcën përbërëse të galaktikave. Tani e dimë se vrimat e zeza janë forca brenda strukturave masive të gjithësisë. Tani, për herë të parë, kemi një mënyrë të re për të studiuar relativitetin e përgjithshëm të vrimave të zeza. Ashtu siç ndodh kur ka zbulime të reja, ky është vetëm fillimi,” thotë zoti Doeleman.

Shkencëtarët tani presin të marrin fotografi të tjera si dhe të përdorin teleskopë më të mëdhenj nga observatorë të lëshuar në hapësirë për të kapur imazhe më të qarta të këtyre objekteve misterioze.

Detyrë 5

Lexoni me kujdes kërkesën e detyrës 5.

Kërkesë:

Plotësoni vendet bosh me numrat 1-12 me fjalët që mungojnë. Në faqen që vijon janë dhënë për çdo vend bosh katër përgjigje të ndryshme. Zgjidhni atë fjalë, që është e përshtatshme për ta bërë tekstin të saktë nga përmbajtja dhe ana gjuhësore.

Një milion specie rrezikojnë **(1)** zhdukjen, për shkak të ndikimit **(2)** të njeriut tek natyra. Sipas një raporti të publikuar së fundmi nga Kombet e Bashkuara, natyra po degradon me një shpejtësi që nuk është parë kurrë më parë, dhe shkak kryesor për këtë është nevoja jonë për më shumë ushqim dhe energji. Këto tendenca mund të ndalen, thotë studimi, por **(3)** një ndryshim thelbësor në çdo aspekt të mënyrës se si njerëzit ndërveprojnë me natyrën. **(4)** bletët që pllenojnë të korrat tona, **(4)** pyjet që parandalojnë përmytjet, janë nën ndikimin e aktivitetit të njeriut, i cili po prish ekosistemet ku speciet ndërveprojnë. Raporti që u publikua këtë të hënë në Paris, tregon më së miri se si njeriu ka trajtuar shtëpinë e tij, planetin Tokë. Sipas dokumentit, **(5)** Toka ka vuajtur gjithmonë nga veprimet e njerëzve, gjatë 50 viteve të fundit, gërvishtjet **(6)** në plagë të thella. Që nga viti 1970, popullsia e botës është dyfishuar, ekonomia botërore është katërfishuar, ndërsa tregtia botërore është dhjetëfishuar. Për t'u ushqyer, veshur dhe dhënë energji botës, pyjet janë spastruar me ritme mbresëlënëse, veçanërisht në zonat tropikale. Mes viteve 1980 dhe 2000, **(7)** 100 milionë hektarë pyje tropikale, shumica **(8)** hapja e fermave të bagëtive në Amerikën e Jugut, si dhe plantacioneve të vajit të palmës, në Azinë Juglindore. Në një situatë më të rëndë se pyjet janë ligatinat, për të cilat **(9)** se vetëm 13 përqind **(10)** që existonin në vitin 1700, vijonin të ekzistonin edhe në vitin 2000. Qytetet tona janë rritur me shpejtësi, dhe zonat urbane janë dyfishuar që nga viti 1992. I gjithë aktiviteti njerëzor **(11)** speciet me shifra shumë më të mëdha se më parë. Një mesatare prej 25 përqind e kafshëve dhe bimëve janë tashmë të kërcënuara. Nuk janë shumë të ditura shifrat për insektet, por në disa zona janë dokumentuar rënie të konsiderueshme në numrin e tyre. E gjithë kjo sugjeron se rreth 1 milion specie, **(12)**

me zhdukjen totale brenda disa dekadave, një ritëm shkatërrimi ky dhjetra, deri qindra herë më i lartë se mesatarja e 10 milionë viteve të fundit.²

Lexoni me kujdes kërkesën e detyrës 5.

Kërkesë:

Plotësoni vendet bosh me numrat 1-12 me fjalët që mungojnë. Në faqen që vijon janë dhënë për çdo vend bosh katër përgjigje të ndryshme. Zgjidhni atë fjalë, që është e përshtatshme për ta bërë tekstin me kuptim dhe të saktë.

Një milion specie rrezikojnë aktualisht (1) zhdukjen, për shkak të ndikimit shkatërrues (2) të njeriut tek natyra. Sipas një raporti të publikuar së fundmi nga Kombet e Bashkuara, natyra po degradon me një shpejtësi që nuk është parë kurrë më parë, dhe shkak kryesor për këtë është nevoja jonë për më shumë ushqim dhe energji. Këto tendenca mund të ndalen, thotë studimi, por do të duhet (3) një ndryshim thelbësor në çdo aspekt të mënyrës se si njerëzit ndërveprojnë me natyrën. Nga (4) bletët që pllenojnë të korrat tona, e deri tek (4) pyjet që parandalojnë përmytjet, janë nën ndikimin e aktivitetit të njeriut, i cili po prish eko-sistemet ku speciet ndërveprojnë. Raporti që u publikua këtë të hënë në Paris, tregon më së miri se si njeriu ka trajtuar shtëpinë e tij, planetin Tokë. Sipas dokumentit, ndërsa (5) Toka ka vuajtur gjithmonë nga veprimet e njerëzve, gjatë 50 viteve të fundit, gërvishtjet janë kthyer (6) në plagë të thella. Që nga viti 1970, popullsia e botës është dyfishuar, ekonomia botërore është katërfishuar, ndërsa tregtia botërore është dhjetëfishuar. Për t'u ushqyer, veshur dhe dhënë energji botës, pyjet janë spastruar me ritme mbresëlënëse, veçanërisht në zonat tropikale. Mes viteve 1980 dhe 2000, u zhdukën (7) 100 milionë hektarë pyje tropikale, shumica nga (8) hapja e fermave të bagëtive në Amerikën e Jugut, si dhe plantacioneve të vajit të palmës, në Azinë Juglindore. Në një situatë më të rëndë se pyjet janë ligatinat, për të cilat mund të thuhet (9) se vetëm 13 përqind e atyre (10) që existonin në vitin 1700, vijonin të ekzistonin edhe në vitin 2000. Qytetet tona janë rritur me shpejtësi, dhe zonat urbane janë dyfishuar që nga viti 1992. I gjithë aktiviteti njerëzor po i vret (11) speciet me shifra shumë më të mëdha se më parë. Një mesatare prej 25 përqind e kafshëve dhe bimëve janë tashmë të kërcënuara. Nuk janë shumë të ditura shifrat për insektet, por në disa zona janë dokumentuar rënie të konsiderueshme në numrin e tyre. E gjithë kjo sugjeron se rreth 1 milion specie, përballen (12) me zhdukjen totale brenda disa dekadave, një

² <https://www.rtsh.al/lajme/raporti-i-okb-se-per-demet-e-shkaktuara-ne-ekosistem-nga-vete-ne-njerezit/>

ritëm shkatërrimi ky dhjetra, deri qindra herë më i lartë se mesatarja e 10 milionë viteve të fundit.

<p>Numër 1</p> <p>A së fundmi B aktualisht C per momentin D ndërkohë</p>	<p>Numër 7</p> <p>A u patën zhdukur B zhdukeshin C zhduken D u zhdukën</p>
<p>Numër 2</p> <p>A shkatërrues B të shkatërruar C shkatërruesë D shkatërrimtar</p>	<p>Numër 8</p> <p>A nga B si pasojë C për shkak D pas</p>
<p>Numër 3</p> <p>A është e nevojshme B ka nevojë C do të duhet D është dashur</p>	<p>Numër 9</p> <p>A mund të thuhet B duhet thënë C lejohet të thuhet D është për t'u thënë</p>
<p>Numër 4</p> <p>A prej ..., e deri ... B si ... ashtu edhe ... C nga ..., e deri tek ... D nga njëra anë ..., nga ana tjetër ...</p>	<p>Numër 10</p> <p>A e të cilave B i kujt C e tyre D e atyre</p>
<p>Numër 5</p> <p>A nëse B ndërsa C megjithëse D kur</p>	<p>Numër 11</p> <p>A po i vret B i vret C po vret D vret</p>
<p>Numër 6</p> <p>A janë kthyer B janë përkeqësuar C janë zhvilluar D janë krijuar</p>	<p>Numër 12</p> <p>A takohen B përballen C përjetojnë D luftojnë</p>

Detyrë 6

Lexoni me kujdes kërkesën e detyrës 6.

Kërkesë:

Në tekstin e mëposhtëm shumë fjalëve i mungon pjesa e dytë. Plotësoni pjesët që mungojnë në fjalë. **(Numri i vendeve bosh i përshtatet numrin të shkronjave munguese)**

Në ambjentet e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë u mbajt ligjërata me temë „Media, gazetaria, demokracia dhe transformimi i opinionit publik“ nga dr. Wiebke Loosen (Instituti për Kërkimin në Media „Hans Bredow“, Hamburg). Ky takim u moderua nga prof. Artan Fuga.

Dr. Wiebke Loosen thek__1 2_3__ funksionin inte1 2 3 4 5 të med1 2 3 , ku n1 2 njëra a1 2 ka p12 detyrë t__ mbledhë d__ të shpër__ temat __ nga a__ tjetër __ duhet t__ mundësojë plura__ e mend__ në n__ mjedis, k__ flukset ja__ të pakuf__ .19

Një pi__ tjetër __ rëndësishme, k__ dr. Loosen u nd__, ishte ed__ trajtimi __ tendencave t__ qeverive p__ të fu__ në do__ mediat. Ajo përmendi ras__ e ble__ së grupit „Dogan“ n__ njerëz t__ afërt t__ Erdoganit, a__ edhe ra__ e Wechat në Kinë, ku sht__ është n__ dijeni t__ çdo komun__ .³

Dr. Wiebke Loosen theksoi funksionin integrues të medias, ku nga njëra anë ka për detyrë të mbledhë dhe të shpërndajë temat e nga ana tjetër i duhet të mundësojë pluralizmin e mendimeve në një mjedis, ku flukset janë të pakufishme.

Një pikë tjetër e rëndësishme, ku dr. Loosen u ndal, ishte edhe trajtimi i tendencave të qeverive për të futur në dorë mediat. Ajo përmendi rastin e blerjes së grupit „Dogan“ nga njerëz të afërt të Erdoganit, apo edhe rasti i Wechat në Kinë, ku shteti është në dijeni të çdo komunikimi.

³ <https://www.fhf.edu.al/fhf-ligjerate-me-teme-media-gazetaria-demokracia-dhe-transformimi-i-opinionit-publik/>